



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

Nr. ekstra Prot.

Elbasan, më 17.03.2020

UDHËZIM

Nr.1, datë 17.03.2020

“PËR

ZHVILLIMIN E PROCESIT MËSIMOR ONLINE NË FAKUTETIN E SHKENCAVE
MJEKËSORE TEKNIKE TË UNIVERSITETIT TË ELBASANIT “ALEKSANDËR
XHUVANI”

Mbështetur në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 43, të Statutit të Universitetit “A.Xhuvani”, Vendimin e Rektorit të UE-së, datë 17.03.2020 “Për zhvillimin e procesit mësimor online në Universiteti të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Dekanati i FSHMT, pas diskutimeve virtuale të zhvilluara në datën 17.03.2020, mbi mënyrat e zhvillimit të procesit mësimor online në FSHMT duke marrë parasysh edhe sugjerimet e stafit akademik,

UDHËZON:

1. Procesi mësimor në Fakultetin Shkencave Mjekësore Teknike të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të zhvillohet online.
2. Zhvillimi i procesit mësimor fillon më datë 17.03.2020 e deri në daljen e një vendimi të dytë për rifillimin e procesit mësimor në auditore me prezencë fizike.
3. Procedurat e zhvillimit të procesit mësimor online do të realizohen si më poshtë:
 - a. Çdo pedagog i stafit akademik të FSHMT, sipas ngarkesës së semestrit të II, të vitit akademik 2019-2020: përcakton formën e komunikimit online, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.
 - b. Krijon grupin virtual me studentët e grupit/kursit (ose minimalisht me përgjegjësat e grupeve), sipas programit të studimit, disiplinës dhe planit mësimor.
 - c. Jep udhëzime, materiale, leksione në formate të ndryshme, lidhur me përvetësimin e disiplinës përkatëse. Formatet e materialeve mund të jenë “word”, “PDF”, “Power Point”, etj.
 - d. U përgjigjet pyetjeve të studentëve për çështje të ndryshme të mësimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

- e. Jep detyra dhe ushtrime lidhur me lëndët në varësi të secilës lëndë.
 - f. Ndjek ecurinë e përgatitjes së detyrave të lëna
 - g. Informon përgjegjësën e njësisë bazë për ecurinë e zhvillimit të procesit mësimor online.
 - h. Dokumenton zhvillimin e procesit mësimor në evidencat përkatëse.
4. Menyrat e komunikimit online, për zhvillimin e procesit mësimor, zgjidhet nga pedagogët duke marrë në konsideratë specifikat e disiplinës respektive, si:
- Google Clasroom
 - WhatsApp
 - Viber
 - e-mail
 - facebook
 - skype
 - të tjera.
5. Ngarkohen përgjegjësit e departamenteve të FSHMT-së për ndjekjen e zbatimit të këtij Udhëzimi.
6. Personeli ndihmës-akademik mbështet dhe lehtëson zhvillimin online të procesit mësimor.
7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DEKANI

Prof.as.Dr. Shkelqim HIDRI